



---

**Shpallje interesi për zhvillimin e**

**Programit të Trajnimit të Detyrueshëm  
për Drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Parashkollor**

**Trajner dhe Trajner Individualë (coach)**

**TERMA REFERENCE (TOR)**

**Tiranë, 2024**

## 1. Qëllimi:

“Shkolla e Drejtorëve të I.A.P” hap thirrjen për procesin e aplikimit të subjekteve qofshin këta persona fizikë apo juridikë për realizimin e Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për certifikimin e drejtuesve të arsimit parashkollor.

“Shkolla e Drejtorëve të I.A.P” është në kërkim të trajnerëve me përvojë në fushën e Lidershipit /Drejtimin të Institucioneve të Arsimit Parashkollor dhe Zhvillimit të Fëmijërisë së Hershme për ofrimin e moduleve të trajnimit në kuadrin e Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Drejtimin e Institucioneve të Arsimit Parashkollor në Shqipëri.

## 2. Prezantimi i Qendrës “Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.”

Qendra “Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.” është krijuar si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) me qëllim mbështetjen e zhvillimit profesional të drejtorëve në detyrë dhe kandidatëve që synojnë të bëhen drejtues në institucionet arsimore parauniversitare publike apo private. Qendra e realizon këtë mision nëpërmjet administrimit të Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për drejtues të këtyre institucioneve, i cili përmbillet me procesin e testimit dhe certifikimit si dhe përmes Programit të Trajnimit për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional për drejtuesit e mësuesit që punojnë në to.

Kjo nismë e strukturuar dhe e qëndrueshme mes AADF dhe MAS është institucionalizuar në marrëveshjen e tyre të nënshkruar më 04 Tetor 2018. Nëpërmjet saj është adresuar nevoja thelbësore që ka i gjithë sistemi arsimor për zhvillimin profesional të drejtorëve të shkollave, bazuar në përfitimet e larta që mund të ketë i gjithë sistemi.

Në këtë kuadër Ministria e Arsimit dhe Sportit ( MAS) propozoi dhe më pas Kuvendi i RSH miratoi Ligjin Nr. 48/2018 datë: 23.07.2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 69/2012 datë 21.06.2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’ i ndryshuar”*. Nga pikëpamja ligjore u bë e detyrueshme që çdo drejtues në detyrë apo kandidat (aspirant) i cili synonte të bëhej drejtues në institucionet e arsimit parauniversitar përfshirë edhe atë parashkollor, duhej të ndiqte Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor (CTP) dhe procesin e testimit për certifikim të realizuar nga CSL.

Mbështetur në këtë ligj , Këshilli i Ministrave miratoi VKM Nr. 540/2018 dt. 19.09.2018 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar për trajnimin dhe certifikimin e tyre”*, ku u përcaktua roli, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e administrimit të këtij institucioni.

### 3. Sistemi i Arsimit Parashkollor në Shqipëri:

Arsimi parashkollor është pjesë e sistemit arsimor dhe është niveli me kodin 0 referuar “Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026”. Mbështetur në të dhënat e vitit 2023-2024, në Republikën e Shqipërisë janë 1843 kopshte publike dhe 226 kopshte private. Kopshtet janë gjithëditore (me ushqim) dhe gjysmëditore (pa ushqim). Një pjesë e kopshteve publike janë në godina të veçanta ndërsa pjesa tjetër janë pjesë e klasave përgatitore parashkollore në shkollat fillore e 9 vjeçare në zonat urbane dhe rurale të RSH.

Sipas Nenit 21, të ligjit Nr. 69/2012, i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, arsimi parashkollor synon: zhvillimin social, intelektual dhe fizik të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave të sjelljes dhe higjienës, kultivimin e vlerave dhe përgatitjen për arsimin fillor. Në të marrin pjesë fëmijë nga mosha 3 deri në 6 vjeç. Fëmijëve të moshës 5 vjeçare u mundësohet ndjekja e mësimi përgatitor në shkollat fillore, me qëllim integrimin në arsimin e detyrueshëm.

Neni 55/1 i Ligjit Nr. 44/2023, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton procedurat për “emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të institucionit të arsimit parashkollor”. Në mbështetje të këtij neni, si dhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve në kopshte, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me mbështetjen teknike të UNICEF-it, ka hartuar “Standardet profesionale për drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor”.

Ligji kërkon që drejtuesi, i cili ka për detyrë drejtimin e veprimtarisë së institucionit arsimor, duhet të jetë përgjegjës për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor, për zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës, për menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe për menaxhimin e burimeve financiare.

Zotërimi i njohurive në fusha të veçanta, si: a) funksionimi i sistemit të arsimit parashkollor, b) politikat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, që lidhen me zhvillimet e fëmijërisë së hershme, c) zhvillimi dhe mësimi i fëmijëve parashkollorë, d) bashkëpunimi me prindërit, si partnerë kryesorë dhe më të interesuar për cilësinë e shërbimeve në kopsht, e) nxitja e mësuesve për zhvillim profesional dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj fëmijëve, prindërve dhe komunitetit etj., kërkon që drejtuesi i institucionit të arsimit parashkollor të përfshihet sistematikisht në procese që ndikojnë në formimin profesional. Këtij procesi i paraprin formimi si drejtues i institucionit arsimor sipas standardeve profesionale dhe përvojave më të mira ndërkombëtare.

### 4. Informacion mbi Programin e Trajnimit të Detyrueshëm për

## **drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor**

Programi i Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor (kopshti) është një program trajnimi i detyrueshëm që ofrohet për drejtuesit në detyrë dhe kandidatat për drejtues që synojnë të bëhen drejtorë të këtyre institucioneve.

Në bazë të ligjit Nr. 44/2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të gjithë individët që do të drejtojnë një institucion të arsimit parashkollor duhet të ndjekin pa shkëputje këtë program dhe të certifikohen në bazë të një procesi testimi të standardizuar.

Qendra “Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.” në bashkëpunim me ekspertë vendas e të huaj ka hartuar Manualin e Programit të Trajnimit të Detyrueshëm për drejtues të institucioneve të arsimit parashkollor.

Manuali i Programit të Trajnimit mbështetet në “Standartet Profesionale për Drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Parashkollor” (Tetor 2021) si edhe në Vlerësimin Kombëtar të Nevojave për Trajnim të Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit Parashkollor, hartuar në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (Prill 2022).

### **5. Modulet e Programit të Trajnimit:**

1. Rritja profesionale si drejtues: ndërtimi i një kulture institucionale dhe profesionale (30 orë);
2. Legjislacioni, menaxhimi dhe burimet njerëzore (23 orë);
3. Zhvillimi i vizionit, misionit dhe strategjisë për përmirësimin e kopshteve dhe Zhvillimi profesional i mësuesve (30 orë);
4. Udhëheqja pedagogjike (30 orë);
5. Kurrikulat, Mësimdhënia dhe Vlerësimi (30 orë);
6. Pjesëmarrja e familjes dhe e komunitetit (23,5 orë);
7. Praktika profesionale.

#### **5.1. Praktika profesionale:**

Praktika profesionale do të zhvillohet në mjediset e kopshteve dhe mbështetet në metodologjinë e mësimin bazuar në projekt. Ky sesion do të frekuentohet vetëm nga drejtuesit aspirantë, të cilët do të mbështeten nga trajnerët individualë (coach) si dhe mentorët (drejtuesit e kopshteve).

## **6. Target-grupi i synuar:**

Target-grupi i synuar i Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për institucionet e arsimit parashkollor janë drejtorët dhe mësuesit që aspirojnë të bëhen drejtorë në institucionet e arsimit parashkollor (kopshti).

## **7. Përbërja e grupit të trajnimit:**

“Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.” mund të trajnojë disa grupe të drejtorëve në detyrë dhe mësuesve aspirantë për drejtorë gjatë të njëjtit brez. Një grup trajnimi mund të ketë deri në 30 pjesëmarrës.

## **8. Kohëzgjatja e trajnimit:**

Një orë trajnimi zgjat 50 minuta me 10 minuta pushim.

## **9. Gjuha:**

Trajnimi do të zhvillohet në gjuhën shqipe..

## **10. Kualifikimet e nevojshme për trajnuesit:**

- Të ketë minimumi gradën shkencore ‘Doktor’ në fushën e edukimit (kriter preferencial) .
- Të ketë formim profesional dhe kontribute në fushën e drejtimit dhe të menaxhimit të arsimit parashkollor, të dëshmuara me certifikata, botime, artikuj si dhe eksperiencë në mësimdhënie në këtë fushë;
- Të jetë njohës i mirë i çështjeve që lidhen me modulet e përshkruara në Programin e Zhvillimit profesional të drejtorëve/aspirantëve për drejtorë, të miratuar nga Bordi i Shkollës së Drejtorëve. Kjo të jetë e dëshmuar me certifikata, botime, artikuj, mësimdhënie apo me detyrat dhe funksionet e vendit të punës;
- Të njohë mirë legjislacionin arsimor parauniversitar që ka të bëjë drejtpërdrejt me veprimtarinë e drejtuesit të arsimit parashkollor dhe që lidhet me modulet e programit (kriter preferencial);
- Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vite eksperiencë pune si lektor ose specialist në fushën e edukimit;

- Të jetë aktivizuar në trajnime për drejtuesit e arsimit parashkollor, lidhur me modulet e programit;
- Përparësi kanë trajnerët që zotërojnë një gjuhë të huaj evropiane (gjuha angleze e preferuar).
- Të ketë eksperiencë të ngjashme trajnimesh në fushën e edukimit dhe lidhshimit në arsimin parauniversitar dhe ose parashkollor.

## **11. Kualifikimet e nevojshme për trajnuesit individualë (coach):**

- Të ketë të paktën një diplomë të nivelit Master ose ekuivalente me të;
- Të ketë përvojë si drejtor i arsimit parashkollor (kriter preferencial);
- Të ketë përvojë të paktën 5 (pesë) vite në punë pedagogjike në sistemin arsimor parauniversitar në lidhje me mësimdhënien, trajnimin ose zhvillimin profesional të mësuesve ose drejtorëve;
- Aktualisht të mos jetë mësues apo drejtor në arsimin parashkollor.

## **12. Kërkesa të tjera:**

Disponueshmëria për të udhëtuar në qytete të ndryshme të Shqipërisë si edhe për të punuar gjatë fundjavës (të premtën pasdite dhe të shtunën) nëse do të lindë nevoja;

## **13. Pritshmëritë:**

Trajnerët e moduleve dhe trajnerët individualë pritet të angazhohen dhe të kryejnë aktivitetet e mëposhtme:

### **13.1. Trajnerët:**

- Hartojnë planin e punës (syllabus) për zhvillimin e trajnimit bazuar në manualin CSL për programin e arsimit parashkollor, duke përfshirë strategjinë dhe metodologjitë e propozuara, si dhe treguesit e cilësisë së trajnimit;
- Kontribuojnë në hartimin dhe pasurimin e bankës së pyetjeve për testimin për certifikim;

- Testojnë dhe vlerësojnë pjesëmarrësit gjatë programit;
- Përdorin platformën online Edu4school për ngarkimin e materialeve të trajnimit dhe elementeve të tjera të kërkuara nga CSL;
- Bashkëpunojnë me trajnerin individual për ofrimin e tematikave për procesin e praktikës profesionale;
- Hartojnë raportin përfundimtar të modulit duke përfshirë problemet e identifikuara dhe sugjerimet për përmirësim sipas strukturës si më poshtë:

Informacion i përgjithshëm mbi modulën dhe procesin e trajnimit;

- Hartimin e programit javor të modulit (një përshkrim i hollësishëm për objektivat e të nxëniet dhe aktivitetet për përmbushjen e tyre);
- Mbajtjen e mungesave dhe vlerësimin e pjesëmarrësve;
- Rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e procesit të trajnimit.

### **13.2. Trajnerët individualë (coach):**

- Përcaktojnë planin e punës për mësuesit aspirantë për drejtues në bashkëpunim të ngushtë me mentorin (drejtorin e kopshtit);
- Bashkëpunojnë ngushtë me trajnerët e moduleve dhe koordinatorin e programit;
- Udhëzojnë, mbështesin dhe kontrollojnë procesin e hartimit dhe zbatimit të projektit përfundimtar;
- Ofrojnë seancat e analizës së praktikës profesionale për drejtuesit dhe aspirantët për drejtues;
- Mbikëqyrin dhe vlerësojnë projektet e pjesëmarrësve të cilët janë drejtues në detyrë;
- Përdorin platformën online Edu4school për ngarkimin e materialeve dhe elementeve të tjera të kërkuara nga CSL,

### **13.3 Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për trajner:**

I gjithë dokumentacioni i depozituar mund të verifikohet mbi autenticitetin përpara firmosjes së kontratës. Deklaratat do të verifikohen gjithashtu. Falsiteti do të shkaktojë skualifikim të menjëhershëm dhe penalizim të aplikantit për propozimet e ardhshme.

### 13.3.1 Kriteret e vlerësimit të aplikimeve:

Kriteri i vlerësimit	Pesha	Tipologjia e Dokumentit	
Eksperiencë akademike në fushën e arsimit parashkollor	30%	1. Lidhja me modulën e përzgjedhur. 2. Diploma	1. Kopje të diplomës/ve dhe certifikatave
Eksperiencë në fushën e arsimit parashkollor dhe femijërinë e hershme	30%	1. Eksperiencë në fushë 2. Eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare 3. Eksperiencë kumulative (të paktën 10 vite në arsimin parashkollor) 4. Referenca	1. Kontakte për referencat 2. Kontrata 3. Links për botime 4. Informacione të tjera relevante
Cilësia e kërkimeve/hulumtime të botuara. (mundësisht në fushën e drejtimit të arsimit parashkollor (të botuara në SCOPUS & WEB of Sciences)	20%	1. Relevanca 2. Ku janë botuar ( konsideroni faktorin e impaktit)	1. Links për botimet
Oferta financiare	20%		Oferta financiare
	100%		

Pagesa për shërbimin do të bëhet pas përfundimit me sukses të modulit të trajnimit ose praktikës profesionale dhe pas depozitimit të dokumenteve të kërkuara në CSL.

### 14. Konsiderata etike dhe konfidencialiteti:

Të gjitha materialet e krijuara sipas kontratës mbeten pronë intelektuale e “Shkollës së Drejtorëve”, e cila sipas nevojës mund t’i përditësojë, përshtasë dhe modifikojë. Ripërdorimi i materialeve nga trajnerët do të kërkojë miratimin formal dhe me shkrim të “Shkollës së Drejtorëve”. Gjithashtu, të gjitha materialet e krijuara në kuadrin e bankës së pyetjeve do të mbahen në diskrecionin e vetëm të CSL-së dhe do të menaxhohen nga stafi i CSL-së. Aktivitetet e trajnerëve të moduleve dhe të trajnerëve individualë gjatë zbatimit të programit do të monitorohen nga CSL, duke përfshirë orët e trajnimit dhe praktikat profesionale.

Trajnerët duhet të zbatojnë detyrimet kontraktuale dhe duhet të përçojnë frymën bashkëpunuese të pjesëmarrësit. Ata duhet të respektojnë konfidencialitetin e informacionit që trajtohet gjatë seancave të trajnimit apo praktikave profesionale. Trajnuesit duhet të hartojnë dhe depozitojnë bankën e pyetjeve në përfundim të modulit sipas udhëzimeve të “Shkollës së Drejtorëve” si edhe të sigurojnë konfidencialitetin dhe cilësinë e pyetjeve të ofruara. Të gjithë trajnerët apo trajnerët individualë duhet të jenë në klasë 15 minuta para fillimit të seancës së trajnimit dhe të sigurohen që materialet e kërkuara janë në dispozicion si dhe infrastruktura e trajnimit është e përshtatshme.



## 15. Proçedura e aplikimit:

Trajnerët dhe trajnerët individualë mund të aplikojnë në më tepër se një modul nëse i përmbushin kriteret.

### Dosja e aplikimit përfshin:

- a) Formularët e aplikimit (bashkëngjitur në aneks);
- b) Propozimi financiar (i detajuar sipas njësisë së llogaritjes);
- c) Diploma dhe certifikata;
- d) Kontaktet për referenca;
- e) Kontratat dhe links për botimet dhe/ose materialet e tjera përkatëse që japin informacion lidhur me përvojën e aplikantit.

## 16. Oferta Financiare:

Pagesa për orën e angazhimit/trajnimin nuk mund të kalojë 2,500ALL/orë (bruto) në rastin e trajnimit në klasë, dhe për trajnerët individualë 12,000ALL/muaj (bruto).

## 17. Aplikimi:

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në adresën [info@csl.edu.al](mailto:info@csl.edu.al), deri më datë 20 maj 2024. Në e-mailin e dërguar duhet të bashkëlidhen dokumentat e kërkuara sëbashku me ofertën financiare.

## 18. Vlerësimi teknik:

Aplikimet do të vlerësohen duke marrë në konsideratë, formimin akademik dhe eksperiencën lidhur me fushën e arsimit parashkollor. Gjithashtu ka rëndësi që moduli për të cilin aplikohet të jetë në përputhje me formimin akademik dhe profesional të aplikantit.

Që aplikimi të konsiderohet fitues do të duhet të akumulojë të paktën 60% të vlerësimit total.

## **18.1 Përzgjedhja e Fituesit:**

Përzgjedhja e aplikantit të suksesshëm do të bazohet në totalin e pikëve të akumuluar nga vlerësimi teknik dhe oferta financiare dhe do të njoftohet nga Shkolla e Drejtorëve nëpërmjet postës elektronike.

## Annex 1

### Compulsory Training Program (Module Description)

#### Program goals:

The program aims to create effective practical training of acting school principals for the improvement of their role, focusing on instructional leadership while raising the commitment to improving the emotional and psychological school climate as well as teaching and learning processes.

#### Structure of the program:

The leadership training program is based on classroom learning in a training school, and experiential learning in field (principal's own schools, and three field visits to other schools) over the period of 5-6 months, All in all, the program consists of 247.5 hours, which include 166.5 hours (28 training days) in the training school, and 81 hours of experiential learning.

#### Structure of the program

W k.	<b>Module 1:</b> Growing as a leader: Building an institutional and professional culture	Hours 30* (excluding experiential learning)
	Introduction: Understanding Myself as a Leader	6
	History of Leadership and Leadership Models	6
	Communication Skills Based on Neuroscience and Psychology	6
	Reflective Practice in Leadership, Mentoring & Coaching	6
	Collaborative Leadership: Setting up an Institutional Culture of Learning and Change	6
	End-of-Module Experiential Learning Assignment: Leadership Experiential Work and Ethical Practice Assignment - Online Submission	
<b>W k.</b>	<b>Module 2:</b> <b>Legislation, Management and Human Resources</b>	<b>Hou rs 23*</b>

	Child Rights Protection under the Albanian Law and the Implications for the Conduct of the Kindergarten. Albanian National Educational Transformational Reforms and Kindergarten Leadership Related Laws and Bylaws	6
	Other Important Educational Laws According to Strategic Changes Amendments, Revisions and Adjustments	6
	Kindergarten Budget Management & Designing the Kindergarten Schedule and Related Priorities	5
4.	Project Cycle and Project Management	6
5.	End-of-Module Experiential Learning Assignment: Fundraising and how to be Engaged to Raise other Resources to be Used for the Kindergarten Mission - Online Submission	

<b>W</b>	<b>Module 3:</b>	<b>Hou</b>
<b>k.</b>	<b>Developing Vision, Mission and Strategy for Kindergarten Improvement. Professional Development of Teachers</b>	<b>rs 30*</b>
	Developing Vision, Mission and Identity of the Preschool and Pedagogical Principles : Vision Mapping and Needs Assessment	6
	Meeting the Teachers' Professional Development Needs: Creating a Continuous Professional Development Plan and Building Staff Capacity	6
	Using Research, Data and Documentation for Quality Improvement, and Planning: Methods of Reading and Analyzing Qualitative and Quantitative Data	6
	Development of a Kindergarten Mid-term and Annual Plan. Leading Adults for Quality Improvement	6
	Development of Time Management Daily Plans, Daily Schedule, Class Tutors, including Individual Educational Plan to Address Areas for Improvement	6
	End-of-Module Experiential Learning Assignment: Teacher and Principal Performance based on Professional Standards and Implementation of Curricular	

	Documents - Online Submission	
--	-------------------------------	--

<b>W</b>	<b>Module 4:</b>	<b>Hours</b>
<b>k.</b>	<b>Pedagogical Leadership</b>	<b>30*</b>
	Science of Early Learning	6
	How Stress and Adversity Impact Young Learners	6
	Strong Relationship and Interactions	6
	The Role of Play in Early Learning and Development	6
	Learning Environment	6
6.	End-of-Module Experiential Learning Assignment: Learning Reflections - Online Submission	

<b>W</b>	<b>Module 5:</b>	<b>Hours</b>
<b>k.</b>	<b>Curricula, Teaching and Assessment</b>	<b>30*</b>
	Curriculum as the Basis of Teaching and Learning - Leading Curriculum Design and Development based on the Albanian National Curriculum Expectations	6
	Child-centered Teaching and Teaching Strategies to Promote Learning	6
	Inclusive Education	6
	Assessment in Preschool Education.	6
	Observation, Documentation, Feedback and Other Tools to Advance Teachers	6
	End-of-Module Experiential Learning Assignment: Presentation and Reporting from Aspiring and Acting Principals for the Tasks and the Assignments Related to Planning and Leading an Observation and Dialogue Teaching - Online	

	Submission	
--	------------	--

<b>W</b>	<b>Module 6:</b>	<b>Hours</b>
<b>k.</b>	<b>Family and Community Participation</b>	<b>23.5</b>
1.	Defining Families in Albania	6
2.	Understanding Partnership with Parents and Community: Development of Kindergarten-Family-Community Partnership and Building Trust in Relationships	6
3.	Meaning and Practices of Family Participation	6
4.	Familiarization Process	5.5
5.	End-of-Module Experiential Learning Assignment: Presentation of the Final assignments related to Leadership of Partnerships with Parents - Online Submission	

*Total inquiry hours for the entire training program: 166.5. Total weeks for the entire training program: 36 weeks (Approximately 8-9 months including submission of the final assignments).*

**Total experiential hours for the entire training program: 81**

**Total hours for the training program: 247**

